POLITIKA PËR BARAZI GJINORE E FBK-SË

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Mbështetur në nenin 24, paragrafi 2, në lidhje me nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së, më 06.11.2026 miratoi këtë:

POLITIKË PËR BARAZI GJINORE TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

HYRJE

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) është e përkushtuar për promovimin e barazisë gjinore si një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë sportive dhe zhvillimit të qëndrueshëm të basketbollit.

Kjo Politikë përbën kornizën institucionale të FBK-së për zbatimin e angazhimeve në fushën e barazisë gjinore, në përputhje me Planin Strategjik 2026–2030 'Basketbolli 3.0', në veçanti me qëllimin strategjik 'Pjesëmarrja e vajzave dhe grave – barazi që fuqizon', si dhe duke marrë në konsideratë prioritetin strategjik të FIBA-s 'Women in Basketball'.

Kjo politikë paraqet angazhimin institucional të FBK-së për të promovuar një kulturë të barazisë, përfshirjes dhe respektit, duke krijuar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen dhe avancimin e vajzave dhe grave si lojtare, trajnere, gjyqtare, delegate teknike, administratore dhe anëtare të organeve vendimmarrëse.

Kjo politikë përcakton parimet, objektivat dhe drejtimin strategjik të FBK-së për promovimin e barazisë gjinore. Synimet dhe indikatorët strategjikë të performancës burojnë nga Plani Strategjik 2026–2030 "Basketbolli 3.0", ndërsa aktivitetet, indikatorët operacionalë, përgjegjësitë, afatet, burimet dhe mekanizmat konkretë për zbatimin e tyre përcaktohen në Planin e Veprimit për Barazi Gjinore dhe dokumentet e tjera zbatuese të FBK-së.

1. Qëllimi i politikës

Qëllimi i kësaj politike është të krijojë një kornizë strategjike për promovimin e barazisë gjinore në basketboll dhe të udhëheqë veprimet e FBK-së drejt rritjes së pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet e sportit.

Në veçanti, politika synon të:

- promovojë dhe rrisë pjesëmarrjen e femrave në të gjitha nivelet e basketbollit;
- krijojë mundësi të barabarta për zhvillim sportiv dhe profesional;
- fuqizojë përfaqësimin e grave në qeverisje & vendimmarrje, si dhe në rolet si trajnere e gjyqtare;
- mbështesë zhvillimin e kulturës organizative të bazuar në barazi, diversitet dhe përfshirje;
- promovojë zhvillimin dhe avancimin e grave në role profesionale dhe udhëheqëse në basketboll;

- promovojë zhvillimin dhe dukshmërinë e basketbollit të vajzave dhe grave, përfshirë garat 5x5 dhe 3x3;
- zbatojë angazhimet që rrjedhin nga Brighton Plus Helsinki Declaration;
- mbështesë realizimin e objektivave përkatëse të përcaktuara në Planin Strategjik 2026–2030 "Basketbolli 3.0".

2. Fusha e zbatimit

Kjo politikë zbatohet për:

- FBK;
- klubet anëtare;
- ligat dhe garat;
- organet drejtuese, komisionet dhe administratën;
- trajnerët;
- gjyqtarët dhe delegatët;
- lojtarët dhe lojtaret;
- çdo person fizik ose juridik që ushtron funksione ose merr pjesë në aktivitetet e organizuara apo të administruara nga FBK-ja.

3. Parimet udhëheqëse

FBK mbështetet në këto parime:

- barazia gjinore;
- mosdiskriminimi;
- mundësitë e barabarta;
- përfshirja dhe diversiteti;
- meritokracia;
- transparenca;
- llogaridhënia;
- respekti dhe integriteti.

4. Vizioni strategjik

Qëllimi: Pjesëmarrja e vajzave dhe grave – barazi që fuqizon

FBK synon të krijojë një ekosistem ku vajzat dhe gratë kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë, për t'u zhvilluar dhe për të kontribuar si lojtare, trajnere, gjyqtare, delegate teknike, administratore dhe udhëheqëse në të gjitha nivelet e basketbollit.

Politika synon jo vetëm të rrisë pjesëmarrjen fillestare të vajzave në basketboll, por edhe të mbështesë vazhdimësinë dhe zhvillimin e tyre përgjatë gjithë ciklit sportiv dhe profesional.

Në këtë kuadër, FBK do të promovojë kalimin e sportisteve aktive drejt roleve si trajnere, gjyqtare, delegate teknike, administratore dhe udhëheqëse sportive.

FBK do të promovojë gjithashtu zhvillimin progresiv dhe të qëndrueshëm të mundësive konkurruese për vajza dhe gra në basketboll, përfshirë formatet 5x5 dhe 3x3, në përputhje me prioritetet strategjike të FBK-së dhe drejtimin "Women in Basketball" të FIBA-s.

FBK do të punojë për rritjen e dukshmërisë dhe promovimit të basketbollit të vajzave dhe grave, duke mbështetur një kulturë që promovon pjesëmarrjen, arritjet dhe rolin e grave në basketboll.

5. Objektivat strategjike

Objektivat strategjike të kësaj Politike harmonizohen me objektivat përkatëse të përcaktuara në Planin Strategjik 2026–2030 "Basketbolli 3.0" dhe përfshijnë:

1. Rritja e numrit të lojtareve femra përmes mbështetjes specifike përgjatë gjithë rrugës së zhvillimit;
2. Rritja e numrit dhe avancimi i trajnereve, gjyqtareve, delegateve teknike dhe zyrtareve femra (përfshirë menaxheret, drejtoret, anëtaret e organeve drejtuese);
3. Rritja e përfaqësimit të grave në organet drejtuese dhe proceset vendimmarrëse;
4. Rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimit të basketbollit të vajzave dhe grave;
5. Zhvillimi i programeve të mentorimit dhe lidershipit për gratë dhe vajzat në sport;
6. Organizimi i një ngjarjeje madhore ndërkombëtare të basketbollit për femra;
7. Zhvillimi dhe zbatimi i politikave për barazi gjinore në të gjitha nivelet.

zhvillimin progresiv dhe të qëndrueshëm të mundësive konkurruese për vajza dhe gra, përfshirë 5x5 dhe 3x3

6. Prioritetet strategjike

6.1 Zhvillimi i basketbollit bazë (grassroots)

- Programe të dedikuara për vajza në shkolla dhe klube;
- Fushata kombëtare për inkurajimin e pjesëmarrjes së vajzave;
- Mbështetje financiare për klubet që zhvillojnë ekipe femrash;
- Krijimi dhe zgjerimi i mundësive për pjesëmarrje të vajzave në basketbollin 5x5 dhe 3x3.

6.2 Rruga e zhvillimit profesional

- Trajnime të dedikuara për trajneret femra;
- Program për zhvillimin e gjyqtareve femra;
- Programe mentorimi (mentorship programs);
- Mbështetje për kalimin dhe avancimin e grave nga pjesëmarrja aktive në role profesionale, administrative dhe udhëheqëse në basketboll.

6.3 Qeverisja dhe vendimmarrja

- FBK do të ndërmarrë masa institucionale për avancimin e përfaqësimit të balancuar gjinor në organet drejtuese, komisionet, administratën dhe strukturat vendimmarrëse, në përputhje me synimet dhe indikatorët e përcaktuar në Planin Strategjik 2026–2030;
- Promovimi i përfaqësimit të balancuar gjinor në organet e saj drejtuese, komisionet dhe strukturat vendimmarrëse, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të grave në proceset e qeverisjes sportive;
- Procese transparente, të drejta dhe jodiskriminuese në emërime, zgjedhje dhe rekrutim;
- Mbështetje në zhvillimin e kapaciteteve dhe mundësive për pjesëmarrjen e grave në strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse.
- Promovimi i zhvillimit të lidershipit të grave dhe krijimi i mundësive për avancimin e tyre në pozita udhëheqëse në sport.

6.4 Integrimi i masave/kushteve në kuadër të procesit të licencimit

- FBK do të inkurajojë dhe promovojë integrimin gradual të kritereve dhe mekanizmave stimulues që mbështesin barazinë gjinore në kuadër të procesit të licencimit të klubeve. Kriteret konkrete, targetet, mekanizmat stimulues dhe mënyra e aplikimit të tyre do të përcaktohen në dokumentet përkatëse të licencimit, sipas nevojave dhe zhvillimit të procesit të licencimit.

6.5 Ruajtja e pjesëmarrjes

- FBK do të promovojë masa që mbështesin vazhdimësinë e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në basketboll, duke krijuar mundësi për kalimin nga roli i lojtares në role të tjera brenda sportit.

7. Partneriteti dhe bashkëpunimi

FBK do të bashkëpunojë me:

- klubet;
- institucionet publike;
- institucionet arsimore;
- organizatat sportive kombëtare dhe ndërkombëtare;
- sponsorët;
- mediat;
- organizatat e shoqërisë civile.

FBK inkurajon gjithashtu klubet dhe partnerët e saj që të zhvillojnë politika dhe praktika të ngjashme në përputhje me këtë dokument.

Në zbatimin e kësaj Politike, FBK do të shfrytëzojë dhe zhvillojë më tej bashkëpunimet dhe iniciativat relevante të zhvilluara në kuadër të FIBA-s, përfshirë proceset dhe rekomandimet e FIBA Plus dhe prioritetin strategjik "Women in Basketball".

8. Përputhshmëria me Brighton Plus Helsinki Declaration

FBK angazhohet që:

- të integrojë barazinë gjinore në politikat dhe strategjitë e saj;
- të zhvillojë masa për rritjen e pjesëmarrjes së grave;
- të promovojë lidershipin e grave;
- të monitorojë progresin;
- të sigurojë vendimmarrje të bazuar në evidencë.

Këto angazhime do të zbatohen në përputhje me Planin Strategjik 2026–2030 "Basketbolli 3.0", këtë Politikë dhe dokumentet përkatëse zbatuese të FBK-së.

9. Monitorimi dhe vlerësimi

FBK do të monitorojë zbatimin dhe ndikimin e kësaj Politike në përputhje me kornizën e monitorimit të Planit Strategjik 2026–2030 dhe indikatorët strategjikë të përcaktuar në të.

Plani i Veprimit për Barazi Gjinore do të operacionalizojë këta objektiva përmes aktiviteteve, indikatorëve operacionalë, afateve, përgjegjësive institucionale, burimeve dhe mekanizmave të raportimit.

Progresi do të vlerësohet periodikisht, duke përfshirë pjesëmarrjen e vajzave dhe grave, zhvillimin dhe avancimin e zyrtareve femra, përfaqësimin në strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse, programet e mentorimit, promovimin dhe dukshmërinë e basketbollit të femrave, si dhe realizimin e iniciativave dhe ngjarjeve të përcaktuara në dokumentet strategjike dhe zbatuese të FBK-së.

Raportimi mbi progresin do të bëhet periodikisht ndaj Bordit të FBK-së, në përputhje me mekanizmat e raportimit të përcaktuar në Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit.

10. Zbatimi

FBK do të sigurojë mekanizmat e nevojshëm institucionalë për zbatimin e kësaj politike, përfshirë grupet e punës, bashkëpunimin me partnerët dhe raportimin periodik ndaj Bordit të FBK-së.

Plani i Veprimit për Barazi Gjinore do të shërbejë si dokumenti kryesor për operacionalizimin e kësaj Politike dhe do të përcaktojë aktivitetet, përgjegjësitë institucionale, afatet, burimet, indikatorët operacionalë dhe mekanizmat e raportimit.

Në hartimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit do të merren në konsideratë puna dhe rezultatet e zhvilluara në kuadër të procesit FIBA Plus, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë dhe shmangies së dublimit të proceseve dhe dokumenteve.

11. Rishikimi i politikës

Kjo politikë do të rishikohet periodikisht, së paku çdo tre (3) vjet, ose më herët nëse këtë e kërkojnë ndryshimet në legjislacion, standardet ndërkombëtare ose prioritetet strategjike të FBK-së.

Rishikimi i Politikës do të bëhet duke marrë parasysh, ndër të tjera, progresin e arritur në zbatimin e Planit Strategjik 2026–2030, rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit, Planin e Veprimit për Barazi Gjinore, zhvillimet përkatëse në kuadër të FIBA-s dhe prioritetet e reja institucionale të FBK-së.

12. Dispozita përfundimtare

Kjo Politikë interpretohet dhe zbatohet në harmoni me Planin Strategjik të FBK-së 2026–2030 "Basketbolli 3.0". Në përcaktimin e synimeve dhe indikatorëve strategjikë të performancës, referencë përbën Plani Strategjik në fuqi, ndërsa Plani i Veprimit për Barazi Gjinore përcakton masat dhe mekanizmat operacionalë për realizimin e tyre.

Kjo Politikë hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i FBK-së dhe zbatohet në përputhje me Statutin, aktet e brendshme të FBK-së dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben **FETAHU**
Kryetar

Prishtinë, 06.11.2026

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVA
FBK
PRISTINA
PRIŠTINA
PRISHTINË